



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-SC-2024-03/KSC-SC-2024-04

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme**

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse  
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart  
Gjykatës Daniel Fransen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 25 shkurt 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** **Publik**

---

**Vendim mbi Kërkesat e Mustafës dhe Prokurores së Specializuar  
për Mbrojtje të Ligjshmërisë**

---

**Prokurores së Specializuar:**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Salih Mustafës:**

Julius von Bone

**Mbrojtjes së Viktimave:**

Ani Puz

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME** i Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Paneli i Gjykatës Supreme" ose "Paneli") duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Kushtetutës,<sup>1</sup> neneve 44(2), 48(6), (7), (8) dhe 64 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar<sup>2</sup> ("Ligji") dhe rregullave 193 dhe 194(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja")<sup>3</sup> ka marrë në shqyrtim Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1 në bazë të nenit 48(6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores ("Kërkesa e Mustafës") dhe Kërkesën e Prokurorisë për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1 kundër Vendimit për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën ("Kërkesa e ZPS-së"), (bashkërisht, "Kërkesat").<sup>4</sup>

## I. ASPEKTE PARAPRAKE

1. Fillimisht, Paneli i Gjykatës Supreme vëren se të dyja kërkesat marrin shkas nga i njëjti vendim dhe në to trajtohen aspekte që në thelb janë të ngjashme. Rrjedhimisht, Paneli do t'i trajtojë të dyja kërkesat së bashku në një vendim, duke marrë parasysh edhe administrimin efikas të procesit gjyqësor. Paneli dëshiron të theksojë se, ndonëse këto dy kërkesa do të shqyrtohen së bashku, vendimi për secilën do të merret në bazë të themelësisë së tyre në përputhje me standardet ligjore në fuqi.

2. Gjithashtu, z. Mustafa kërkon që procesi në Gjykatën Supreme të pezullohet në pritje të vendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Gjykata Kushtetuese") mbi kërkesën referuese të z. Mustafa drejtuar asaj gjykate.<sup>5</sup> Paneli i

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Kosovës (me amendamentet I-XXIV), 5 gusht 2015.

<sup>2</sup> Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr. 05/L-053.

<sup>3</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

<sup>4</sup> KSC-SC-2024-03/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë në bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores me Shtojcën Publike 1, 9 dhjetor 2024; KSC-SC-2024-04/F00001, Kërkesë e Prokurorisë për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, me Shtojcën Publike 1, 10 dhjetor 2024.

<sup>5</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 42. Shih gjithashtu, KSC-CC-2024-27/F00001, Prokurorja e Specializuar k. Salih Mustafës, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Salih Mustafa të Garantuara nga Nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së

Gjykatës Supreme vëren se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në bazë të nenit 48(6) të Ligjit dhe kërkesa referuese drejtuar Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 49(3) të Ligjit, janë dy mundësi juridike të veçanta dhe, në shumë aspekte, të dallueshme, në dispozicion të z. Mustafa - dhe për secilën zbatohen standarde ligjore të ndryshme. Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu vëren se këto mjete juridike të veçanta dhe të dallueshme në dispozicion të z. Mustafa, drejtohen kundër dy vendimeve të ndryshme të lëshuara nga panele të ndryshme.<sup>6</sup> Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme rrëzon kërkesën e z. Mustafa për pezullimin e procesit deri në lëshimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

## II. HISTORIKU PROCEDURAL

3. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I lëshoi Aktgjykimin me të cilin e shpalli z. Salih Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.<sup>7</sup> Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.<sup>8</sup>

4. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi Urdhrin për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, me të cilin e urdhëroi z. Mustafa t'u paguante 207.000 euro viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor, si kompensim për dëmin e shkaktuar.<sup>9</sup>

---

Republikës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me Shtojcat publike 1 deri 7, 27 shtator 2024 ("Kërkesa Referuese e Mustafës drejtuar Gjykatës Kushtetuese").

<sup>6</sup> KSC-CA-2023-02/F00045, Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, 10 shtator 2024 ("Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit"); KSC-SC-2024-02/F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024 ("Vendimi mbi Kërkesën e Parë të Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë" ose "Vendimi i Gjykatës Supreme").

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 (KSC-BC-2020-05/F00494/COR) dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2023 (KSC-BC-2020-05/F00494/RED3/COR).

<sup>8</sup> Aktgjykimi, para. 831.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-05/F00517, Urdhër për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 prill 2023 (konfidencial), para. 283. Versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim u dorëzua po atë ditë (KSC-BC-2020-05/F00517/RED) dhe versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik u dorëzua më 14 prill 2023 (KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR).

5. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Aktgjykimin e Apelit, me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë të z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.<sup>10</sup> Në këtë kuadër, Paneli i Gjykatës së Apelit uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>11</sup>
6. Më 29 korrik 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Parë të Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, me të cilin, ndër të tjera, anuloi Aktgjykimin e Apelit vetëm në lidhje me dënimin e z. Mustafa dhe ia ktheu atë Panelit të Apelit për të marrë një vendim të ri dënimi për z. Mustafa në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores.<sup>12</sup>
7. Më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Vendimin për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, me të cilin uli dënimin z. Mustafa në 15 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>13</sup>
8. Më 27 shtator 2024, z. Mustafa i parashtroi Gjykatës Kushtetuese një kërkesë referuese me të cilën kundërshtonte vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme.<sup>14</sup>
9. Përkatësisht më 9 dhe 10 dhjetor 2024, z. Mustafa dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzuan Kërkesat e tyre.
10. Përkatësisht më 10 dhe 11 dhjetor 2024, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për të vendosur në lidhje me Kërkesat.<sup>15</sup>
11. Më 31 janar 2025, ZPS-ja dorëzoi Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Kërkesës së

---

<sup>10</sup> KSC-CA-2023-02/F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023 (konfidencial), para. 484. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u lëshua po atë ditë (KSC-CA-2023-02/F00038/RED).

<sup>11</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

<sup>12</sup> Vendimi mbi Kërkesën e Parë të Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 112.

<sup>13</sup> Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit të Mustafës, para. 28.

<sup>14</sup> Kërkesa Referuese e Mustafës drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

<sup>15</sup> KSC-SC-2024-03/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 10 dhjetor 2024; KSC-SC-2024-04/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 11 dhjetor 2024.

Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1 ("Përgjigjja e ZPS-së") dhe z. Mustafa dorëzoi Përgjigjen e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimit për Salih Mustafën (Përgjigjja e z. Mustafa").<sup>16</sup>

12. Më 17 shkurt, Mbrojtja e z. Mustafa dorëzoi Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ("Kundërpërgjigjja e Mustafës") dhe ZPS-ja dorëzoi Kundërpërgjigjen e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Saj për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1 ("Kundërpërgjigjja e ZPS-së").<sup>17</sup>

### III. PRANUESHMËRIA

13. Paneli thekson se Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit është i formës së prerë dhe se të dyja Kërkesat u dorëzuan brenda afatit tremujor të përcaktuar në nenin 48(6) të Ligjit, pas lëshimit të atij Vendimi. Rrjedhimisht, Kërkesa e Mustafës dhe Kërkesa e ZPS-së janë të pranueshme, dhe për rrjedhojë Paneli do të vijojë me vlerësimin e tyre.

### IV. STANDARDI I SHQYRTIMIT

14. Paneli rikujton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të karakterizohet si apel i shkallës së tretë, sikurse përcaktohet në nenin 47 të Ligjit, dhe në të nuk ngrihen aspekte bazuar në nenin 48(1) - (5) të Ligjit. Ajo është një mjet juridik i jashtëzakonshëm i parashikuar në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe rregullat 193 dhe 194 të Rregullores. Qëllimi i saj nuk është që të krijojë një mundësi tjetër të

---

<sup>16</sup> KSC-SC-2024-03/F00004, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1, 31 janar 2025; KSC-SC-2024-04/F00004, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, 31 janar 2025.

<sup>17</sup> KSC-SC-2024-03/F00005, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 17 shkurt 2025; KSC-SC-2024-04/F00005, Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Saj për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcën Publike 1, 17 shkurt 2025.

përgjithshme për apel.<sup>18</sup> Përkundrazi, dhe ngjashëm me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës,<sup>19</sup> kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet vetëm për rastet specifike të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore. Sikurse ka theksuar Gjykata Supreme e Kosovës:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kriteret e rrepta të pranueshmërisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale.<sup>20</sup>

15. Rrjedhimisht, ndaj arsyeve mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen kritere të rrepta të pranueshmërisë.

16. Në vlerësimin e secilës arsye, Paneli përcakton nëse ka shkelje të të drejtës penale të përfshirë në Ligj ose shkelje të konsiderueshme të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.

17. Argumentet që logjikisht mund të ishin paraqitur para paneleve në shkallë të parë dhe të dytë, nuk mund të paraqiten *de novo* para Panelit të Gjykatës Supreme.<sup>21</sup>

18. Gjithashtu, arsyet mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, me të cilat pretendohen konstatime të gabuara ose të paplota të fakteve, nuk janë në kompetencën e këtij Paneli dhe për rrjedhojë, janë të papranueshme.<sup>22</sup>

19. Thjesht mospajtimi me vlerësimin e fakteve nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, ose përsëritja fjalë për fjalë e parashtrimeve të bëra në apelet e mëparshme, pa trajtuar në mënyrë substanciale vendimin e kundërshtuar apo aktgjykimin e formës

---

<sup>18</sup> KSC-SC-2023-01/F00021, Vendim mbi Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 18 shtator 2023 (“Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj”), para. 9; KSC-BC-2020-06, PL001/F00008, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 15 gusht 2022 (“Vendimi në lidhje me Veselin”), para. 21.

<sup>19</sup> Shih nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 08/L-032, Gazeta Zyrtare nr. 24, 17 gusht 2022.

<sup>20</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, S.S., Pml.Kzz 42/2017, Aktgjykim, 10 maj 2017, para. 23.

<sup>21</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10.

<sup>22</sup> Rregulla 193(3) e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 25.

së prerë dhe pa evidentuar gabimin apo shkeljen konkrete të pretenduar, janë po ashtu të pamjaftueshme për të përmbushur standardin e pranueshmërisë së këtyre arsyeve.<sup>23</sup>

20. Lidhur me shkeljet e përcaktuara në nenin 48(7) të Ligjit, për shkak të të cilave kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë, Dhoma e Gjykatës Supreme rikujton se ka përcaktuar më parë standardin e shqyrtimit që zbatohet për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që bazohen në *shkelje të konsiderueshme të procedurave* në aktgjykimet e formës së prerë.<sup>24</sup> Paneli rikujton standardin e lartë të përcaktuar në nenin 48(7)(b) të Ligjit në lidhje me shkeljet e konsiderueshme procedurale.<sup>25</sup> Më konkretisht, Paneli vendosi se “shkelje të konsiderueshme” të procedurave ka kur shkelja “ka ndikim juridikisht thelbësor në konstatimin gjyqësor”.<sup>26</sup> Pretendimi për shkelje të konsiderueshme të procedurave, sikurse përcaktohet në Ligj dhe Rregullore, duhet të vlerësohet *rast pas rasti*, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat bazohet secila kërkesë.<sup>27</sup>

21. Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu rikujton se mund të konstatojë shkelje të konsiderueshme të procedurave në qoftë se, për shembull, Paneli i Gjykatës së Apelit: (i) nuk ka zbatuar një dispozitë të Ligjit apo Rregullores; (ii) ka zbatuar në mënyrë të gabuar Ligjin dhe/ose Rregulloren; ose (iii) ka shkelur të drejtat e Mbrojtjes në një mënyrë që ka ndikuar në dhënien e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë.<sup>28</sup>

22. Paneli gjithashtu përcaktoi standardin e shqyrtimit që zbatohet në lidhje me shkeljen ose shkeljet e të drejtës penale të përcaktuara në nenin 48(7)(a) të Ligjit.<sup>29</sup> Paneli konstatoi se ky nen nuk kërkon që shkelja e të drejtës penale të jetë “e

---

<sup>23</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 25.

<sup>24</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 13.

<sup>25</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

<sup>26</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

<sup>27</sup> Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, NV, Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4, 10-12; AM, Pml.Kzz 84/2015, Aktgjykim, 12 maj 2015, f. 3-4; M.L., Pml.Kzz 26/2015, Aktgjykim, 18 mars 2015, f. 5-7.

<sup>28</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 24.

<sup>29</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

konsiderueshme”<sup>30</sup>

23. Gjithashtu, Paneli vëren listën shteruese të shkeljeve të ligjit penal të përcaktuara në nenin 385(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe konsideron si shkelje të tij vetëm ato të përmendura në këtë nen. Konkretisht, këto shkelje ndodhin kur: (i) vepra për të cilën ndiqet penalisht i akuzuari, nuk është vepër penale; (ii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale, sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë; (iii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale; (iv) lidhur me veprën e penale është zbatuar një ligj që nuk mund të zbatohet; (v) në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim, gjykata ka tejkalar kompetencat ligjore; ose (vi) janë shkelur dispozitat për sa i përket llogaritjes së periudhës së paraburgimit, arrestit shtëpiak, çdo periudhë të heqjes së lirisë si dhe të dënimit të kryer më parë për veprën penale që është objekt i procedurës penale.<sup>31</sup>

24. Paneli thekson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të bazohet edhe në nenin 48(8) të Ligjit, ku përcaktohet se kërkesa për mjete juridike të jashtëzakonshme mund të paraqitet edhe në bazë të të drejtave sipas këtij Ligji, të cilat gjithashtu janë të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”). Paneli gjykon se çdo pretendim për shkelje të të drejtave sipas Ligjit, të cilat mbrohen edhe nga KEDNJ-ja, duhet të përmbushë të njëjtin standard shqyrtimi të përcaktuar më lart.<sup>32</sup>

---

<sup>30</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

<sup>31</sup> Neni 385(1)(1.1-1.6) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

<sup>32</sup> Shih Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 18; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 33.

25. Paneli në vijim ka konstatuar se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë qartë shkeljen e pretenduar të ligjit, ta faktojë atë dhe, në rastin e shkeljes së procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.<sup>33</sup>

26. Së fundi, Paneli rikujton rregullën 194(1) të Rregullores, në të cilën përcaktohet se, nëse Paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli:

- (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar; ose
- (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent; ose
- (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.

27. Pasi ka rikujtuar standardin e shqyrtimit, Paneli i Gjykatës Supreme do të trajtojë arsyet mbi të cilat bazohen Kërkesat.

## V. DISKUTIM

### A. PRETENDIMI PËR SHKELJE NË LIDHJE ME DËNIMIN E DHËNË PËR SHPALLJEN FAJTOR PËR VRASJE TË PALIGJSHME (PIKA 1 E KËRKESËS REFERUESE TË MUSTAFËS)

#### 1. Parashtrimet

28. Z. Mustafa parashtron se Paneli i Apelit e zbatoi gabim nenin 44(2)(a) dhe (5) të Ligjit kur e dënoi atë me 15 vjet burg pasi e shpalli fajtor për vrasje të paligjshme si krim lufte.<sup>34</sup> Si alternativë, z. Mustafa pretendon se Paneli i Apelit nuk e zbatoi nenin 44(2)(a) dhe (5) të Ligjit në përputhje me nenin 33(3) të Kushtetutës, i cili nuk u mor parasysh prej Panelit të Apelit.<sup>35</sup> Z. Mustafa kërkon që dënimit të tij me 15 vjet burgim për vrasje të paligjshme si krim lufte, t'i bëhet një ulje e përgjithshme.<sup>36</sup>

29. Në veçanti, z. Mustafa parashtron se dënimi me 15 vjet burgim që iu dha për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, është joproporcional në kuptim të nenit 33(3)

---

<sup>33</sup> Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 19; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

<sup>34</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 26.

<sup>35</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 26. Shih gjithashtu Kërkesën e Mustafës, para. 30-33.

<sup>36</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 26, 40-41, 43.

të Kushtetutës.<sup>37</sup> Z. Mustafa argumenton se Paneli i Apelit nuk mori parasysh jurisprudencën e Kosovës, ku në raste të ngjashme me të tjin, janë dhënë dënime më të ulëta, dhe se rrjedhimisht, ai u trajtua ndryshe nga individë të tjerë të gjykuar në Kosovë, në shkelje të nenit 33(3) të Kushtetutës.<sup>38</sup>

30. ZPS-ja parashtron se Kërkesa duhet të rrëzohet *in limine*. Prokuroria vëren se në Kërkesën e Mustafës pretendohet për shkelje të së drejtës penale, por ajo ka të bëjë vetëm me të drejtën e z. Mustafa për dënim proporcional dhe, rrjedhimisht, me këtë Kërkesë synohet të ngrihet pretendimi për shkelje të konsiderueshme procedurale.<sup>39</sup> ZPS-ja gjithashtu argumenton se në Kërkesën e Mustafës: (i) pretendohet pa të drejtë për konstatim të gabuar ose jo të plotë të fakteve; (ii) paraqiten argumente që logjikisht mund të ishin paraqitur më parë; (iii) përsëriten argumente që janë paraqitur më parë; dhe (iv) kundërshtohen konstatimet e bëra në Aktgjykim, në Aktgjykimin e Apelit dhe/ose në Vendimin e Gjykatës Supreme, jo në Vendimin për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit.<sup>40</sup> Rrjedhimisht, ZPS-ja pretendon se Kërkesa e Mustafës është e papranueshme dhe duhet të rrëzohet menjëherë.<sup>41</sup>

31. Lidhur me themelësinë e Kërkesës së Mustafës, ZPS-ja përgjigjet se pjesëmarrja e z. Mustafa në krime dhe numri i viktimave nuk përlligjin dhënien e një dënimi më të butë. ZPS-ja argumenton se në Kërkesën e Mustafës shpërfillen rrethanat konkrete të çështjes dhe faktorët që duhet të merren parasysh, ndër të cilët shkallëzimi i dënimit i përcaktuar në nenin 44(1) të Ligjit që zbatohet në Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe shkallëzimi jodetyrues i dënimit i pasqyruar në nenin 44(2)(b) të Ligjit dhe i evidentuar në Vendimin e Gjykatës Supreme.<sup>42</sup>

32. ZPS-ja parashtron se dënimet e bazuara në Kodin e RSFJ-së nuk përlligjin

---

<sup>37</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 28. Shih gjithashtu Kërkesën e Mustafës, para. 27, 29, 38-39.

<sup>38</sup> Kërkesa e Mustafës, para. 36. Shih gjithashtu Kërkesën e Mustafës, para. 37.

<sup>39</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 4.

<sup>40</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 5. Shih gjithashtu Përgjigjen e ZPS-së, para. 6-7.

<sup>41</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 8. Shih gjithashtu Përgjigjen e ZPS-së, para. 1.

<sup>42</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9. Shih gjithashtu Përgjigjen e ZPS-së, para. 10-11, 13-14.

dhënien e një dënimi më të butë. ZPS-ja argumenton se "parashtrimet e përgjithshme në Kërkesën e Mustafës për numrin e viktimave dhe veprimet e kryesve në çështje gjyqësore të tjera, të bëra në kuadër të një kornize ligjore të ndryshme, nuk demonstronë, pa argumente të tjera, 'një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme', siç do të nevojitej në mënyrë që këto çështje të ishin relevante".<sup>43</sup> ZPS-ja parashtron se pretendimi i z. Mustafa se 'vonesa' në ndjekjen penale duhet t'i 'zbritet' nga dënimi, është i pabazë.<sup>44</sup> Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja parashtron se Gjykata Supreme duhet ta rrëzojë Kërkesën në tërësi.<sup>45</sup>

33. Z. Mustafa kundërpërgjigjet se krahasimi me çështje gjyqësore të tjera nga juridiksionet e Kosovës ose nga jurisprudenca ndërkombëtare - TPNJ dhe TPNR, demonstron se ka një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme dhe tregon shproporcionalitetin e dënimit të z. Mustafa sipas Pikës 4 të Aktakuzës.<sup>46</sup> Gjithashtu, z. Mustafa argumenton se do të ishte e padrejtë që ai të dënohej për një vrasje të vetme të kryer në vitin 1999, bazuar në standardet gjyqësore të kohëve të fundit.<sup>47</sup> Z. Mustafa gjithashtu argumenton se të drejtat e z. Mustafa për gjykim të drejtë e përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së u shkelën, sepse në dhënien e dënimit për z. Mustafa nuk u mor parasysh vonesa e ZPS-së në ndjekjen penale të tij.<sup>48</sup> Z. Mustafa rithekson se (i) dënimi me 15 vjet burgim është joproporcional me veprën penale për të cilën akuzohet sipas Pikës 4 të Aktakuzës, (ii) nuk është zbatuar neni 33(3) i Kushtetutës, dhe (iii) neni 44(2) i Ligjit është zbatuar gabim nga Paneli i Apelit.<sup>49</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit

34. Paneli vëren se z. Mustafa nuk përcakton nëse arsyeja e tij përbën shkelje të

<sup>43</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 16. Shih gjithashtu Përgjigjen e ZPS-së, para. 17-19.

<sup>44</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 18.

<sup>45</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 15, 20.

<sup>46</sup> Kundërpërgjigjja e Mustafës, para. 18-20, 23-24.

<sup>47</sup> Kundërpërgjigjja e Mustafës, para. 13-16, 22.

<sup>48</sup> Kundërpërgjigjja e Mustafës, para. 21.

<sup>49</sup> Kundërpërgjigjja e Mustafës, para. 25. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Mustafës, para. 4-11.

konsiderueshme të procedurave apo shkelje të të drejtës penale. Sidoqoftë, me sa kupton Paneli, argumentet e z. Mustafa kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës penale për shkak të keqpërdorimit të pretenduar të kompetencës ligjore prej Panelit të Apelit në lidhje me zbatimin prej tij të nenit 44(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pika 1 e Kërkesës së z. Mustafa është e pranueshme dhe do të shqyrtojë themelësinë e saj.

35. Fillimisht, Paneli rikujton se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë kompetencë të gjerë diskrecionale në përcaktimin e dënimit me burgim dhe se ka pranuar se dënimi me 22 vjet burgim i dhënë në fillim prej Panelit të Apelit në Aktgjykimin e Apelit, ishte brenda shkallëzimit prej pesë deri në 25 vitesh burgim të konstatuar prej Panelit të Gjykatës Supreme.<sup>50</sup> Paneli gjithashtu rikujton konstatimin se "panelet e shkallëve më të ulëta nuk janë të detyruara të zbatojnë shkallëzimin e përcaktuar të dënimit, por e marrin parasysh atë. Në fakt, edhe faktorë të tjerë, ndër të cilët neni 44(2)(c) i Ligjit dhe rrethanat e veçanta të çështjes gjyqësore, merren parasysh prej panelit në përcaktimin e dënimit të duhur me burgim".<sup>51</sup>

36. Paneli vëren se, në Vendimin për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, Paneli i Apelit ndoqi konkretisht konstatimet e përcaktuara në Vendimin e Gjykatës Supreme, shkallëzimin e dënimit të përcaktuar në të, si dhe jurisprudencën ndërkombëtare përkatëse.<sup>52</sup> Paneli rikujton se rrethanat që lidhen me krimet për të cilat u shpall fajtor z. Mustafa, përfshirë vrasjen e paligjshme, u shqyrtuan gjerësisht prej Trupit Gjyqësor dhe dy herë prej Panelit të Apelit.<sup>53</sup>

37. Paneli vë në dukje se Paneli i Apelit saktësoi se ishte përqendruar vetëm në jurisprudencën ndërkombëtare, dhe nuk përfshiu jurisprudencën e Kosovës, për

---

<sup>50</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 106.

<sup>51</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 106.

<sup>52</sup> Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, para. 9-16, 18-21.

<sup>53</sup> Shih Aktgjykimin, para. 689, 692, 695, 798, 802, 812-826; Aktgjykimin e Apelit, para. 350, 352-354, 458-463; Vendimin për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, para. 16, 19.

shkak të pazbatueshmërisë në çështjen Mustafa të shkallëzimit të dënimit të përcaktuar në Kodin Penal të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976 ("Kodi i RSFJ-së").<sup>54</sup> Paneli thekson se z. Mustafa nuk e kundërshton këtë aspekt të analizës së Panelit të Apelit, por përqendrohet vetëm në natyrën joproporcionale të pretenduar të dënimit të tij për vrasje të paligjshme si krim lufte.<sup>55</sup> Gjithashtu, Paneli i Apelit shtjelloi edhe proporcionalitetin e dënimit të z. Mustafa në kuptim të nenit 33(3) të Kushtetutës.<sup>56</sup>

38. Paneli vëren se dënimi me 15 vjet burgim i dhënë prej Panelit të Apelit për vrasjen e paligjshme si krim lufte, është qartësisht brenda shkallëzimit të dënimit me 25 vjet burgim të evidentuar prej Panelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 44(2)(a) të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli është i mendimit se z. Mustafa nuk demonstroi se si Paneli i Apelit mund të kishte arritur në një konstatim të ndryshëm në këtë kontekst.<sup>57</sup> Paneli konstaton se z. Mustafa thjesht nuk pajtohet me ushtrimin prej Panelit të Apelit të diskrecionit të vet dhe se ai nuk ka përcaktuar se si dënimi me 15 vjet burgim përbën shkelje të së drejtës penale. Në mënyrë të ngjashme, Paneli rrëzon argumentin e z. Mustafa se ai u dënua sipas "një standardi të vendosur së fundmi" për përcaktimin e dënimeve. Z. Mustafa thjesht nuk pajtohet me konstatimet e Panelit të Gjykatës Supreme në lidhje me shkallëzimin e evidentuar të dënimit, dhe zbatimin e parimit *lex mitior*, në një përpjekje për të ridebatuar juridikisht të njëjtin aspekt për të cilin tashmë është marrë vendim. Rrjedhimisht, hidhet poshtë Arsyeya 1 e z. Mustafa.

B. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 44(1), 44(2) (B) DHE (C) TË LIGJIT (PIKAT 1 DHE 2 TË KËRKESËS REFERUESE TË ZPS-SË)

### 3. Parashtrimet

39. ZPS-ja parashtron se Paneli i Apelit nuk mori parasysh nenin 44(1) të Ligjit,

---

<sup>54</sup> Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, poshtëshënimi 51.

<sup>55</sup> Shih në përgjithësi Kërkesën e Mustafës.

<sup>56</sup> Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit, para. 17, 24, 26.

<sup>57</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 107.

sipas të cilit dënimi më i lartë që mund të jepet në Dhomat e Specializuara për krimet e luftës, është ai me burgim të përjetshëm.<sup>58</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se, kur vendosi për uljen e dënimit të z. Mustafa, Paneli i Apelit nuk iu referua nenit 44(2)(c) të Ligjit.<sup>59</sup> Sipas ZPS-së, neni 44(1) i Ligjit përcakton të vetmin shkallëzim dënimi që Dhomat e Specializuara janë të detyruara ta zbatojnë, dhe Paneli i Apelit ishte gjithashtu i detyruar të merrte parasysh nenin 44(2)(c) të Ligjit.<sup>60</sup>

40. ZPS-ja parashtron se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk lejon që shkallëzimi i detyrueshëm i dënimit me burgim të përjetshëm të kufizohet në ndonjë mënyrë, përfshirë nëpërmjet marrjes parasysh të shkallëzimeve jodetyruese të dënimeve të përcaktuara në nenin 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit.<sup>61</sup>

41. ZPS-ja gjithashtu argumenton se ndonëse Paneli i Apelit iu referua shkallëzimit të dënimit nga pesë deri në 25 vjet burgim në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit, ai nuk trajtoi dhe nuk analizoi më tej burimin e shkallëzimit të dënimit, konkretisht Kodin Penal të Kosovës të vitit 2019.<sup>62</sup> ZPS-ja parashtron se Paneli i Apelit gjithashtu nuk mori parasysh praktikat e dënimit në Kosovë në raport me Kodin Penal të Kosovës të vitit 2019, sipas të cilave zotit Mustafa mund t'i ishte dhënë dënimi me burg nga 21 vjet deri në burgim të përjetshëm për një vrasje të vetme.<sup>63</sup>

42. Z. Mustafa pretendon se ZPS-ja po i ngre për herë të parë në këtë Kërkesë aspektet e parashtruara në Pikën 1, pasi në fazat e mëhershme nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim për to - përfshirë këtu Aktgjykimin e Apelit dhe Vendimin e Gjykatës Supreme.<sup>64</sup> Z. Mustafa argumenton se këto aspekte nuk mund të ngrihen në kërkesën e ZPS-së dhe se ato e bëjnë Pikën 1 të papranueshme, pasi nuk janë shterur mjetet

---

<sup>58</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 22.

<sup>59</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 22.

<sup>60</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 22. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 25-28.

<sup>61</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 23. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 24.

<sup>62</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 29. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 30-31, 33.

<sup>63</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 32, që i referohet Udhëzuesit për Matjen e Dënimit, Gjykata Supreme, 2018, f. 141-143.

<sup>64</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 22, 24. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 27.

juridike të disponueshme.<sup>65</sup>

43. Z. Mustafa përgjigjet se Paneli i Apelit nuk ka detyrim të bëjë vlerësimin e proporcionalitetit të nenit 44(1) të Ligjit, dhe as të përmendë apo diskutojë nenin 44(2)(c) të Ligjit, siç parashikohet nga ZPS-ja.<sup>66</sup> Z. Mustafa gjithashtu argumenton se, në qoftë se pretendimi për gabim lidhet me faktin se a u analizua apo u diskutua diçka, kjo, në vetvete, nuk mund të përbëjë shkelje të Ligjit.<sup>67</sup> Z. Mustafa parashtron se argumenti i paraqitur prej ZPS-së bazohet në një "interpretim të gabuar të nenit 44(2)(c) në kontekst të nenit 44(2)(a) dhe (b), dhe në kontekst të konventave dhe neneve kushtetuese përkatëse që përmban ai".<sup>68</sup> Gjithashtu, z. Mustafa argumenton se Paneli i Apelit në fakt e mori parasysh nenin 44(2)(c) të Ligjit.<sup>69</sup> Për arsyet e mësipërme, z. Mustafa pretendon se Pika 1 duhet të hidhet poshtë.<sup>70</sup>

44. Meqenëse ZPS-ja u shpreh qartë se Vendimi i Gjykatës Supreme ishte i formës së prerë, z. Mustafa parashtron se ai nuk mund të kundërshtohet nga e para në këtë proces.<sup>71</sup> Z. Mustafa argumenton se Pika 2 nuk përmbush standardin e pranueshmërisë dhe duhet të shpallet e papranueshme ose ndryshe të hidhet poshtë ose të refuzohet menjëherë.<sup>72</sup>

45. Z. Mustafa argumenton se parashtrimi i ZPS-së se Paneli i Apelit gaboi që zbatoi shkallëzimin e dënimit nga pesë deri në 25 vjet burgim, është i pasaktë,<sup>73</sup> dhe rikujton se ishte Gjykata Supreme ajo që, në përputhje me parimin *lex mitior*, pranoi shkallëzimin e dënimit nga pesë deri në 25 vjet burgim - Paneli i Apelit thjesht ishte i detyruar ta merrte parasysh atë.<sup>74</sup> Rrjedhimisht, z. Mustafa pretendon se Pika 2 nuk

---

<sup>65</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 33, 45. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 27, 31-32.

<sup>66</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 35, 45. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 36-42.

<sup>67</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 35, 48. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 43, 49.

<sup>68</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 66. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 50-63.

<sup>69</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 66. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 65.

<sup>70</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 44, 64.

<sup>71</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 68-69. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 67, 71.

<sup>72</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 69-70.

<sup>73</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 80. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 76.

<sup>74</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 72. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 73-75, 77-79.

mbështetet në fakte dhe, për rrjedhojë, duhet të hidhet poshtë ose të refuzohet menjëherë.<sup>75</sup>

46. ZPS-ja kundërpërgjigjet se cilësimi prej z. Mustafa i Vendimit të Dënimit thjesht si zbatim i drejtpërdrejtë i udhëzimeve të Gjykatës Supreme, është i pasaktë.<sup>76</sup> ZPS-ja argumenton se në Kërkesë tregohen shkelje të konsiderueshme të të drejtës procedurale dhe penale në vlerësimin e ri të dënimit prej Panelit të Apelit, i cili, ndër të tjera, anashkaloi dhe zbatoi në mënyrë të gabuar faktorë që duhej t'i kishte pasur parasysh, dha arsyetim të mangët dhe tejkaloi kompetencën ligjore të Panelit të Apelit.<sup>77</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se interpretimi kufizues i nenit 44(2)(c) të Ligjit prej z. Mustafa, si ligj që zbatueshëm vetëm kur "personi mund të mos dënohej fare" si rezultat i zbatimit të nenit 44(2)(a)-(b) të Ligjit, është i pabazë dhe do t'i hiqte dispozitës kuptimin dhe qëllimin e drejtpërdrejtë.<sup>78</sup> Për këto arsye, ZPS-ja përsërit pretendimin e saj se Kërkesa e ZPS-së është e pranueshme dhe duhet të miratohet në tërësi.<sup>79</sup>

#### 4. Vlerësimi i Panelit

47. Paneli vëren se ZPS-ja duket se argumenton se me zbatimin që i bëri nenit 44 të Ligjit, Paneli i Apelit shkeli të drejtën penale .

48. Paneli rikujton se Paneli i Apelit e zbatoi të drejtën penale në përputhje me Vendimin e Gjykatës Supreme.<sup>80</sup> Çka është e rëndësishme, Paneli vëren se ZPS-ja nuk argumenton se Paneli i Apelit nuk e zbatoi të drejtën penale në përputhje me Vendimin e Gjykatës Supreme. Në vend të kësaj, ZPS-ja thjesht nuk pajtohet me dispozitat ligjore përcaktuar nga Paneli i Gjykatës Supreme, dhe po përpiqet të ridebatojë juridikisht një aspekt, vendimi për të cilin është marrë tashmë prej Panelit

---

<sup>75</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 80.

<sup>76</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2.

<sup>77</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2.

<sup>78</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 4.

<sup>79</sup> Kundërpërgjigjja, para. 5. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e ZPS-së, para. 1, 3.

<sup>80</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 35-37.

të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se thjesht mospajtimet me vendimet janë të pamjaftueshme për përmbushjen e standardit të lartë që një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të ketë sukses. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë menjëherë Pikat 1 dhe 2.

C. PRETENDIMI PËR MOSDHËNIE TË MENDIMIT TË ARSYETUAR DHE MOSDËGJIM TË PALËVE DHE PJESËMARRËSVE (PIKAT 3 DHE 4 TË KËRKESËS REFERUESE TË ZPS-SË)

### 1. Parashtrimet

49. ZPS-ja parashtron se Paneli i Apelit kishte "detyrimin - por nuk e bëri këtë - të jepte mendim të arsyetuar që të përmbante faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe raportin logjik mes tyre".<sup>81</sup> Sipas ZPS-së, kjo solli si rezultat "një vendim arbitrar, në të cilin nuk u trajtuan aspektet thelbësore të çështjes, nuk u sigurua që 'çdo palë dhe pjesëmarrës në çështje të jetë plotësisht i informuar për rezultatin në një mënyrë të parashikueshme', dhe palëve dhe pjesëmarrësve t'u mundësohej të kërkonin në mënyrë të efektshme mjete juridike të përshtatshme".<sup>82</sup>

50. ZPS-ja parashtron se Vendimi për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit u bazua në masë vendimtare në dy çështje të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ"), dhe pranoi se Paneli i Apelit ishte shprehur se i kishte analizuar këto vendime dhe se ato "mund të ishin relevante".<sup>83</sup> Sidoqoftë, ZPS-ja parashtron se Paneli i Apelit nuk bëri ndonjë analizë apo të jepte një shpjegim në lidhje me këto dy çështje gjyqësore.<sup>84</sup>

51. ZPS-ja gjithashtu parashtron se palët dhe pjesëmarrësit kanë të drejtë të dëgjohen në lidhje me aspektin vendimtar të përcaktimit të dënimit, për të cilin palët

---

<sup>81</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 34. (citimet e brendshme janë hequr). Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 35-36.

<sup>82</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 34. (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>83</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 37.

<sup>84</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 37. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 38.

kanë mendime të kundërta, dhe Paneli i Apelit nuk e bëri këtë.<sup>85</sup> ZPS-ja parashtron se vendimi i Panelit të Apelit për t'u mbështetur në parashtrimet mbi përcaktimin e dënimit që u dorëzuan para daljes së Vendimit për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit për [z. Salih Mustafa], rezultoi në një vendim arbitrar dhe u kontribuoi shkeljeve të evidentuara prej ZPS-së në Pikat 1 deri 3.<sup>86</sup> ZPS-ja parashtron se parashtrimet e bëra më parë u bazuan në faktorë të ndryshëm dhe nuk morën parasysh bazën e re ligjore të përcaktuar në Vendimin e Gjykatës Supreme, që përmbante "aspekte të reja dhe themelore".<sup>87</sup>

52. Z. Mustafa përgjigjet se një shkelje procedurale që bazohet në "mungesën e arsytimit", duhet të shkaktohet si rezultat i mungesës pothuajse të plotë të mendimit të arsyetuar, gjë që në këtë rast nuk ka ndodhur.<sup>88</sup> Rrjedhimisht, z. Mustafa argumenton se Pika 3 nuk mbështetet në fakte dhe, duke qenë se argumentet nuk janë të faktuara, kjo pikë është e papranueshme.<sup>89</sup>

53. Z. Mustafa parashtron se Paneli i Apelit dha vendim të arsyetuar "në përputhje me Ligjin dhe analizoi rrethanat konkrete të çështjes të pasqyruara si në Aktgjykimin [e Apelit], ashtu dhe në Vendimin e Dënimit".<sup>90</sup> Z. Mustafa argumentoi se mendimi i arsyetuar për një aktgjykim apo vendim nuk përcakton ndonjë kriter të detyrueshëm për të përcaktuar se kur përmbushet standardi i dhënies së mendimit të arsyetuar.<sup>91</sup> Z. Mustafa gjithashtu argumenton se Paneli i Apelit shikoi jurisprudencën nga tribunalët e tjerë ndërkombëtarë dhe mbajti parasysh se për vepra penale të njëjta ose të ngjashme me ato për të cilat u shpall fajtor z. Mustafa, kishte një mori vendimesh.<sup>92</sup> Duke marrë parasysh sa më lart, z. Mustafa argumenton se Pika 3 duhet të hidhet

---

<sup>85</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 39.

<sup>86</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 40.

<sup>87</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 40.

<sup>88</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 82. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 83.

<sup>89</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 85. para. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 86-88, 91, 96.

<sup>90</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 92.

<sup>91</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 94. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 95.

<sup>92</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 93.

poshtë ose të refuzohet menjëherë.<sup>93</sup>

54. Z. Mustafa rikujton se Paneli i Apelit i njoftoi palët dhe pjesëmarrësit se nuk ishte e nevojshme të dorëzonin parashtrime me shkrim, pasi më parë kishin dorëzuar parashtrime të shumta.<sup>94</sup> Duke qenë se në atë kohë asnjë prej palëve nuk shprehu kundërshtime dhe as kërkoi t'i jepej mundësia të paraqiste parashtrime të mëtejshme, z. Mustafa argumenton se Pika 4 është e papranueshme ose duhet të hidhet poshtë menjëherë.<sup>95</sup>

55. Z. Mustafa argumenton se Panelit të Apelit iu dhanë udhëzime nga Gjykata Supreme për të marrë një vendim të ri dënimi, ku të evidentonte kuadrin ligjor të zbatueshëm sipas të cilit do të jepej vendimi i ri i dënimit.<sup>96</sup> Z. Mustafa parashtron se Vendimi nuk është marrë *proprio motu* apo mbi bazat e paraqitura.<sup>97</sup> Z. Mustafa gjithashtu argumenton se Paneli i Apelit përdori udhëzime dhe faktorë shtesë që nuk janë të rinj, çka përlligji mbështetjen e tij në parashtrimet e bëra në një fazë të mëhershme.<sup>98</sup> Z. Mustafa parashtron se ZPS-ja nuk solli fakte të mëtejshme se pse vendimi i kundërshtuar nuk ishte i ligjshëm.<sup>99</sup> Për këto arsye, z. Mustafa parashtron se Pika 4 duhet të hidhet poshtë.<sup>100</sup>

56. ZPS-ja kundërpërgjigjet se, siç u parashtrua më herët, argumentet në Kërkesën e ZPS-së nuk mund të ngriheshin më parë, sepse në Vendimin për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit u interpretua dhe u zbatua Vendimi i Gjykatës Supreme, pa dëgjuar argumentet e palëve apo pjesëmarrësve, të drejtat dhe interesat e të cilëve u cenuan.<sup>101</sup>

---

<sup>93</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 98.

<sup>94</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 100.

<sup>95</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 101, 107. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 102-105.

<sup>96</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 108.

<sup>97</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 111.

<sup>98</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 111. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 109-110, 112-116, 118.

<sup>99</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 119. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 117, 120.

<sup>100</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 121.

<sup>101</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 3.

## 2. Vlerësimi i Panelit

57. Sipas Panelit, ZPS-ja pretendon se me mosdhënien e një mendimi të arsyetuar, Paneli i Apelit bëri shkelje të konsiderueshme të procedurave. Paneli rikujton se Paneli i Apelit u udhëzua prej Panelit të Gjykatës Supreme të rishqyrtonte dënimin e z. Mustafa, në përputhje me udhëzimet që iu dhanë nga ai Panel. ZPS-ja nuk demonstroi se si Paneli i Apelit nuk iu përmbajt Vendimit të Gjykatës Supreme dhe vëren se Paneli i Apelit e arsyetoi gjerësisht vendimin e vet dhe iu referua udhëzimeve që iu dhanë në këtë aspekt.

58. Rrjedhimisht, ZPS-ja thjesht nuk pajtohet me ligjin e zbatueshëm të përcaktuar prej Panelit të Gjykatës Supreme. Paneli rikujton se thjesht mospajtimet me vendimet janë të pamjaftueshme për përmbushjen e standardit të lartë që kërkohet për miratimin e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

59. Lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, Paneli rikujton se ZPS-ja pati mundësi të paraqiste pikëpamjet e veta mbi ligjin dhe shkallëzimet e dënimeve të zbatueshme para Panelit të Gjykatës Supreme, si dhe para Trupit Gjykes dhe Panelit të Apelit.<sup>102</sup> Paneli vëren se ZPS-së iu dha mundësia të paraqiste pikëpamjet e veta në lidhje me zbatimin e nenit 44 të Ligjit dhe shkallëzimin e dënimit të zbatueshëm në rastin e z. Mustafa.<sup>103</sup> Në lidhje me këtë, Paneli vëren se ZPS-ja nuk paraqiti asnjë argument alternativ, as para Trupit Gjykes, as para Panelit të Apelit apo këtij Paneli, kur z. Mustafa argumentoi se shkallëzimi i dënimit që duhej të zbatohet ishte ai me pesë deri në 15 vjet burgim, sipas Kodit të RFSJ-së.<sup>104</sup> Në fakt, qëndrimi i ZPS-së në lidhje me dënimin e z. Mustafa ishte mjaft i qartë dhe është marrë parasysh nga panele të ndryshme gjatë gjithë procesit penal. Konkretisht, ZPS-ja ka qenë gjithmonë e mendimit se z. Mustafa duhet të dënohet me 33 vjet burgim për shpalljen fajtor për

---

<sup>102</sup> Aktgjykimi, para 763-766; Aktgjykimi i Apelit, para. 442-446; Vendimi i Gjykatës Supreme, para. 68-70.

<sup>103</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 59, 68-70.

<sup>104</sup> Shih Aktgjykimin, para 763-766; Aktgjykimin e Apelit, para. 442-446; Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 68-70.

vrasje të paligjshme si krim lufte.<sup>105</sup> Meqenëse se ZPS-ja i kishte paraqitur tashmë parashtrimet e veta para Gjykatës së Apelit, dhe vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme thjesht sqaroi kuadrin ligjor të zbatueshëm pa ndryshuar konstatimet faktike, nuk kishte nevojë për argumente të mëtejshme. Gjykata e Apelit kishte vetëm detyrimin të zbatonte standardin e korrigjuar ligjor, i cili duhet të ishte zbatuar *ab initio*, dhe ZPS-së nuk iu shkaktua asnjë dëm që parashtrimet e saj nuk u dëgjuan përsëri. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë menjëherë Pikat 3 dhe 4.

D. SHKELJA E PRETENDUAR E NENEVE 44 DHE 46 TË LIGJIT (PIKA 5 E KËRKESËS REFERUESE TË ZPS-SË)

### 1. Parashtrimet

60. ZPS-ja parashtron se "shkeljet e konsiderueshme procedurale" të përshkruara në Pikat 1 deri 5 të Kërkesës së ZPS-së, "patën ndikim thelbësor në të gjitha aspektet vendimtare të Vendimit për Lëshimin e Vendimit të Ri të Dënimit për z. Salih Mustafa, duke e bërë atë arbitrar dhe qartazi të paarsyeshëm".<sup>106</sup> Rrjedhimisht, sipas ZPS-së, argumentet e paraqitura në Pikën 1 deri 4 tregojnë se Paneli i Apelit tejkaloi kompetencat e veta ligjore, të përcaktuara në nenin 44 dhe 46 të Ligjit.<sup>107</sup> Për këtë arsye, ZPS-ja kërkon që Paneli: "(i) të anulojë në tërësi Vendimin e Dënimit; dhe (ii) t'ia kthejë çështjen Panelit të Apelit vetëm për dhënien e një dënimi të ri që është në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren".<sup>108</sup>

61. Z. Mustafa përgjigjet se kjo Pikë nuk përmban asgjë specifike lidhur me tejkalinimin e kompetencave ligjore dhe nuk ofron asnjë përmbajtje, gjë që e bën të pamundur që t'i jepet përgjigje.<sup>109</sup> Z. Mustafa parashtron se kjo Pikë është e papranueshme, pasi në të nuk tregohet se cilat janë gabimet në vendimin e

<sup>105</sup> Shih Aktgjykimin, para 766; Aktgjykimin e Apelit, para. 442; Vendimin e Gjykatës Supreme, para. 68-70.

<sup>106</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 41.

<sup>107</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 41. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 43-44.

<sup>108</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 42. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 43-45.

<sup>109</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 126-127. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mustafës, para. 122, 124-125.

kundërshtuar. Si alternativë, z. Mustafa parashtron se ajo duhet të hidhet poshtë ose të refuzohet menjëherë.<sup>110</sup>

62. ZPS-ja kundërpërgjigjet se në Kërkesën e Prokurorisë tregohen shkelje të konsiderueshme të së drejtës procedurale dhe penale në vlerësimin e ri të dënimit prej Panelit të Apelit, i cili, ndër të tjera anashkaloi ose zbatoi gabim parimet që duhej t'i merrte parasysh, dha arsyetim të mangët dhe tejkaloi kompetencën ligjore të Panelit të Apelit.<sup>111</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit

63. Paneli rikujton se ka hedhur poshtë Pikat 1 deri 4 të Kërkesës së ZPS-së. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se argumentet e ZPS-së janë të tejkaluara dhe hedh poshtë Pikën 5.

---

<sup>110</sup> Përgjigjja e Mustafës, para. 128.

<sup>111</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2.

VI. VENDIM

64. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës Supreme **RRËZON** në tërësi Kërkesat e Salih Mustafës dhe të ZPS-së.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse**

E martë, 25 shkurt 2025

Në Hagë, Holandë.